

V E N D I M
Nr. 257, datë 13.6.2002

**PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E PAGIMIT TË KONTRIBUTEVE PËR SIGURIMET
SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet përkatëse, dhe të nenit 11 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Personat, juridikë e fizikë, të paraqesin në bankën ku kanë llogarinë rrjedhëse urdhrin për pagimin e kontributeve mujore për sigurimet shoqërore e shëndetësore jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

2. Institucionet buxhetore të paraqesin në bankën ku kryejnë veprimet e tyre, nëpërmjet llogarisë së Drejtorisë së Thesarit, së bashku me çekun për tërheqjen e pagave të pesëmbëdhjetëditëshit të dytë, urdhrin për pagimin e kontributeve mujore për sigurimet shoqërore e shëndetësore; ndryshe institucioni buxhetor nuk mund të tërheqë pagat e punonjësve.

3. Të vetëpunësuarit, individë a pjesëtarë në ortakëri, ose dhe personat që sigurohen vullnetarisht, pagimin e kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore mund ta bëjnë edhe me para në dorë, pranë bankave ose në rrjetin e postës shqiptare, brenda afateve dhe kriterëve në fuqi.

4. Instituti i Sigurimeve Shoqërore të lidhë marrëveshje me bankat e nivelit të dytë dhe me postën shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi nr.261, datë 7.6.1993 i Këshillit të Ministrave “Për derdhjen e detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko